

JULIA NAVARRO



NGA
ASNJËRA
ANË



Letërsi e huaj bashkëkohore
Julia Navarro
Nga asnjëra anë
DITURIA

Nga e njëjta autore:

- Vëllazëria e Pëlhurës së Shenjtë
 - Më thuaj kush jam
 - Qëlllo, tashmë jam i vdekur
 - Bibla prej argjile

Julia Navarro

Nga
asnjëra anë

Përktheu: Flavia Kaba

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:
Julia Navarro

De ninguna parte

Redaktore: Jeta Hamzallari
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

Copyright © 2021, Julia Navarro
Copyright © për botimin shqip, DITURIA, 2023



Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të Komisionit Europian. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimet e mundshme të informacioneve që përmban teksti.

Shtëpia Botuese DITURIA
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë
P.O. Box 1441
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503
E-mail: sekretaria@dituria.al
www.dituria.al
■ Shtëpia Botuese DITURIA

*Të shtrenjtit tim Fernando Escribano,
është privilegj të jem mikja jote.*

Për Jesús Barderasin dhe José Maria San Juanin me të cilët ruaj miqësi prej dekadash. Ky roman ndoshta filloi të merrte formë shumë vite më parë, gjatë një udhëtimi që bëme së bashku për në Lindjen e Mesme.

*Dhe kur mendova se nuk kisha më vend për miq të tjerë,
José Manuel Lorenzo u shfaq si një vorbull
me gjallërinë e tij molepsëse.*

*Edhe për Enrique Arnaldon, gjithnjë bujar
kur është fjala për miqësi.*

Për Alba Fernándezin, jeta e së cilës është ende e pashkruar, dhe për Juan Manuelin, gjyshin e saj.

Libri 1

Paris. Mesnatë.

Abiri.

Kurrë nuk kam fjetur me një grua. Nuk mund t'ia lejoj vetes. Mund të flas nëpër gjumë dhe të nxjerr ndonjë gjë që mund të më tradhtojë. Jeta ime është përqendruar tanimë në vrasje dhe arratisje. Vrasje dhe arratisje. Vrasje dhe arratisje.

Gruaja që njoha mbrëmë më përcolli te dera duke gogësirë. Dukej e lehtësuar teksa më shihte të largohesha. Pas disa minutash, ka për të më harruar fytyrën, as unë nuk do t'ia kujtoj dot emrin.

Shkoj gjithnjë me profesioniste, sepse dua thjesht një shfryrje të shpejtë. Ka pasur raste kur kanë këmbëngulur që të qëndroj, por nuk kam lejuar që diçka e tillë të ndodhë, nga frika se mos më merrte gjumi.

Kënaqem teksa shëtit në vetmi. Kaloj pranë grave që ekspozojnë trupin nëpër qoshe rrugësh, ndërsa burrat për të cilët punojnë, i këqyrin duke tymosur në pragjet e dyerve të shtëpive.

Pyes veten se si mund të jetë ta kalosh gjithë natën me një grua. Ndoshta kurrë nuk do ta mësoj. Kur isha adoleshent, ëndërroja një të ardhme, kur netët dhe ditët do t'i kaloja me Marionën.

Eci drejt Lagjes nr. 10, kaloj fare pranë apartamentit ku ajo jetonte me të motrën, Lizetën. Nuk pres që ta shoh. U bënë vite që është larguar, por teksa shkel te rruga e saj më duket sikur e kam pranë.

Mariona... së shpejti do të shihemi sërish. Të premtova se do të bëja diçka të madhe.

Sonte, si shumë net të tjera, e shkuara më është rikthyer dhe e kam të vështirë të njoh te vetja adoleshentin që isha dikur. Ende më zënë dridhmat kur kujtoj ditën e mbërritjes në Paris bashkë me vëlla Ismailin dhe ungj Xhemalin...

Abiri dhe Ismaili, dy jetimë të trembur që nuk kishin mundësi zgjedhjeje. Për shkak të një tragjedie. Tragjedisë sime. Vrasjes së prindërve tanë në Ain al-Hilweh. Ajo komandë izraelite na la jetimë.

Mbyll sytë për ta kujtuar më mirë, edhe pse tutem të rijetoj atë që ndodhi asokohe dhe që sot është kthyer në një makth që nuk më lë të fle.

Abiri mori frymë thellë dhe i la kujtimet ta tërhiqnin pas, në të shkuarën. Vazhdonte ta ruante të gjallë në kujtesë atë agim në Ain al-Hilweh, kur çifutët prishën ëndrrat e familjes së tij. Nuk kishin punë me ta, por me sheh Muhsinin. Shehu kishte ardhur të vizitonte kunatin e së ëmës.

I ati, Xhaferi, i urdhëroi që të largoheshin dhe Abiri mbërtheu për dore Ismailin, ndërsa e ëma, Gada, i ndiqte nga pas me motrën e tyre të vogël në krahë, të ëmblën Dunia. U hodhën nga një dritare. Buçima e të shtënave mbështolli agun. E ëma u pengua dhe ra përmbys. Koka e Dunias u përplas përdhe dhe u mbulua nga gjaku, ndërsa e ëma klithte. Abiri u kthye që të shkonte t'i ndihmonte, por pikërisht në atë çast u dëgjuan të shtëna, të ndjekura nga një shpërthim dhe britmat e sheh Muhsinit, i cili u kërkonte që të vraponin. Abiri arriti tek e ëma, u përkul dhe u përpoq ta tërhiqte nga dora. Por u tmerrua kur pa se ishte plagosur. Ishte futur në mes që të mos lejonte që plumbat e çifutëve t'i merrnin jetën shehut. Dhe atje, në rrugë, dha frymën e fundit. Abiri rrëmbeu një gur dhe e tundi në ajër, duke u klithur atyre zagarëve të ndyrë çifutë se do t'i vriste. Dhe do ta mbante premtimin. Madje po e mbante.

Pas vrasjes së prindërve, djemtë qëndruan edhe për ca kohë në Ain al-Hilweh. Ishte një kamp refugjatësh, por ata ishin mësuar dhe aty ndiheshin të sigurt. Më vonë, familja vendosi se do të ishin më mirë në Bejrut. Kushërinjtë e tyre, Xhibrami, Samiu dhe Roshama, bënë ç'ishte e mundur për t'u lehtësuar dhembjen.

Qëndruan atje, derisa Xhemal Adoumi, ungji i të atit, erdhi për t'i marrë. Kur kishte mësuar se çfarë kishte ndodhur, nuk kishte ngurruar të kthehej në Liban, për të marrë përsipër përgjegjësinë për dy jetimët e nipit të tij Xhaferit, të martuar me Gadën. E kishte për detyrë.

Ungj Xhemali ishte njeri modest, punonte si elektrikist. Fillimisht, kishte emigruar në Francë, në kërkim të një pune, por pastaj... pastaj, për shkak të Nurës, e kishte provuar fatin në Belgjikë, duke u vendosur në Bruksel. Teto Fatima ishte grua e mirë, ndërsa kushëriri, Faridi, gëzonte respektin e familjes për dhembshurinë dhe mençurinë e tij. Sa për Nurën, kushërirën, Abiri e kishte fort për zemër, edhe pse sjellja e saj e pahijshme shpesh e vinte në siklet.

Ndihej mirënjohës ndaj të ungjit, sepse i kishte birësuar. U dha mbiemrin dhe i mësoi të ishin njerëz të mirë e besimtarë të devotshëm të Allahut. Bëri çmos që as Abiri dhe as Ismaili i vogël të mos mungonin kurrë në xhami, as edhe një herë të vetme. Kur ndonjëri prej tyre sëmurej dhe e shoqja i kërkonte që të qëndronin në shtëpi, Xhemali kundërshtonte. Nuk kishte justifikime për të mos shkuar çdo të premtë për t'u falur përkrah vëllezërve që ruanin besimin në atë qytet mëkatar.

Ungji nuk mendonte se duhej t'u ishin mirënjohës të pafeve. I kishin lejuar të jetonin mes tyre, domosdo, ama jetesën e fitonin vetë. Gjithçka e siguronin me mund e djersë, kështu që nuk u detyroheshin për asgjë. Punonin shumë dhe paguheshin. Ata nuk e konsideronin si njërin prej tyre, por as ai vetë nuk dëshironte të ndiente se i përkiste atij vendi. Një ditë, Europa do të binte si frutë e pjekur në duart e besimtarëve.

Xhemali nuk i fali kurrë çifutët dhe i ushqeu fëmijët dhe dy nipërit me urrejtjen ndaj vrasësve. Kurrë nuk i lejoi që të harronin, madje as që të shëronin plagët.

Dhe atij, Abirit, iu desh të mësonte që të mbijetonte në Paris. U përpoq të kishte rezultate të mira në mësimet për të pasur kështu vlerësimin e mësuesve dhe u detyrua të bënte siç bënin djemtë e tjerë; madje, fshehtas të ungjit, edhe pinte e tymoste. Nuk donte ta pranonte, as brenda vetes, por ende i kujtohej se sa shumë i pëlqente shija e verës. Shokët e shkollës qeshnin me të, që nuk kishte guximin

t'u fuste dorën poshtë fundeve shoqeve të klasës. Derisa një ditë e bëri.

Në të vërtetë, imitonte sjelljen e djemve të tjerë që të ndihej pjesë e botës së tyre dhe u rrinte larg myslimanëve. Nuk dëshironte të ishte ndryshe. Përpiqej me mish e me shpirt që ta konsideronin francez, por ata djem kurrë nuk reshtën së pari atë si një "arab" dhe qeshnin me të teksa e thërrisnin ashtu. Ngjyra e lëkurës, veshja, theksi i tij grykor... sado që të muntohej, kurrë nuk do të ishte si të tjerët. Madje kishte kaluar një periudhë rebelimi kur nuk pranonte kurrsesi të fliste arabisht në shtëpi. Dëshironte të fliste vetëm frëngjisht dhe filloi t'i urrente gatimet e teto Fatimës. Disa herë, ungi e ndëshkoi, duke e rrahur me rripin e mesit. Ende ka ndonjë vragë tek-tuk në kurriz. Xhemali e urdhëroi të sillej si një mysliman i mirë dhe të mos përpiqej të shndërrohej në atë që nuk do të ishte kurrë.

"Përse duhet të heqim dorë nga besimet dhe zakonet tona për t'i kënaqur ata? Një ditë e gjithë Europa do të jetë jona dhe të pafetë do të konvertohen."

I ungi kishte të drejtë. Tani ishte i sigurt se do t'ia dilnin. Europeanët ishin të dobët, burracakë. Ishin tepër të zënë duke u përpjekur të ruanin pamjen e jashtme. Pa dëshirë, i kishin hapur dyert e kontinentit dhe, pa e kuptuar, të gjithë do të bëheshin pjesë e islamit.

Ndezi një cigare dhe e thithi fort derisa iu mbushën mushkëritë. Vazhdoi të fliste me veten, duke i lënë mendimet të rridhnin.

Do t'i kishte pëlqyer t'i afrohej shtëpisë ku dikur kishte jetuar me ungjin dhe teton. Por ndokush mund ta njihte dhe kjo gjë do ta vinte në rrezik.

Vuri dorën sipër xhepit dhe preku çelësin e shtëpisë, ku mund të pushonte. I përkiste një burri të cilin as që e njihte, i ngarkuar të gjente vende të sigurta për "vëllezërit" të cilët u përkisnin grupeve të Rrethit në Europë.

Burri merrte me qira apartamente dhe shtëpi për luftëtarët dhe anëtarët e qelizave të fjetura. Abiri ishte bërë një nga zëvendësit e sheh Muhsinit që udhëhiqte luftëtarët e Rrethit. Shehu kurrë nuk e kishte harruar se prindërit e Abirit kishin sakrifikuar jetët e tyre për ta mbrojtur. Dhe meqë kishin edhe një lidhje të largët familjare,

kishte aq besim tek ai, sa ta linte të organizonte disa sulme në të cilat merrnin pjesë, edhe pse ndonjëherë Abiri largohej para se të kryheshin. Sheh Muhsini thoshte që “ende” e donte të gjallë dhe se do të vinte edhe momenti i martirizimit.

Ai ndihej krenar që kishte besimin e shehut; kjo bënte që edhe burrat e tjerë ta respektonin, por e detyronte po ashtu të shfaqte trimërinë pa u lëkundur.

Kishte ecur thuajse dy orë dhe ndihej i lodhur. Mbërriti te rruga ku ndodhej streha e tij. Ndali të ndizte një tjetër cigare e të kontrollonte se mos shihte gjësend që t’i tërhiqte vëmendjen. Rruga ishte e shkretë, ndaj u çapit me hap të qetë drejt derës. E hapi dhe ngjiti tinëz shkallët. U ndje i lehtësuar që gjendej diku i sigurt. Brenda pak ditësh do të udhëtonte për në Bruksel, por më parë duhej të përgatiste me përpikëri hollësitë e operacionit që do të kryente. E tërë bota do të shtypej nën këmbët e tij. Do t’i poshtëronte të pafetë ashtu siç askush më parë kishte guxuar dhe Mariona, pavarësisht nga ç’mendonte, do ta adhuronte për këtë gjë.